



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E BUJQËSISË, VETERINARISË, PYJEVE DHE MJEDISIT

Nr. 8190 Prot.

Divjakë më 31.07.2025

LËNDA: PROJEKT PËR KONSULTIM PUBLIK.

“MBI DISKUTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE”

Në mbështetje të nenit 54 dhe 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 11 dhe 14 të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre, Ligjit nr. 9693/2007 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, Ligji nr. 72/2012 “Për kullotat dhe livadhet”; Vendimit i Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 13.7.2022 “Për miratimin e kriterëve për përdorimin dhe shfrytëzimin e pyjeve dhe të kullotave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore”.- Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Pyjeve 2020–2030; mbështetur edhe në relacionin e paraqitur nga Njësia e Mjedisit dhe Pyjeve pranë Bashkisë Divjakë, Këshilli Bashkiak, pas diskutimeve dhe shqyrtimit të materialeve përkatëse

1. Të miratojë Planin e Mbarështrimit të Pyjeve të Bashkisë Divjakë për periudhën 2025–2035, si dokument strategjik orientues për administrimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të fondit pyjor publik në territorin e Bashkisë Divjakë.
2. Zbatimi i Planit të Mbarështrimit të Pyjeve do të realizohet nga struktura përgjegjëse e pyjeve pranë Bashkisë Divjakë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse qendrore dhe lokale, si dhe me pjesëmarrjen e komunitetit lokal.
3. Ngarkohet Njësia e Mjedisit dhe Pyjeve dhe Njësia e Planifikimit Strategjik për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të Planit.

Specialist agronom dhe emergjencave civile

Ferit Qosja

Specialist agronom dhe emergjencave civile

Fabiona Bani

**Përgjegjës i sektorit juridik dhe
prokurimeve publike**

Andi Bullari

KRYETARI

JOSIF GORREA





RELACION PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE PËR BASHKINË DIVJAKË

1.0101 - HYRJE

Bashkia Divjakë, në zbatim të Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, ka përfunduar hartimin e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve për territorin e saj administrativ. Hartimi i këtij plani është një hap thelbësor për garantimin e një përdorimi të qëndrueshëm, mbrojtës dhe ekonomik të fondit pyjor publik në pronësi të bashkisë, si dhe për ruajtjen e funksioneve ekologjike, sociale dhe prodhuese të pyjeve.

II. BAZA LIGJORE

Plani i Mbarështrimit të Pyjeve bazohet në:

- Ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet",
- Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe udhëzimet përkatëse për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve,
- Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Sektorit Pyjor,
- Kompetencat e njësisë të vetëqeverisjes vendore në lidhje me administrimin e pasurive natyrore, sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

III. QËLLIMI I PLANIT

Qëllimi kryesor i Planit të Mbarështrimit të Pyjeve për Bashkinë Divjakë është:

- Të garantojë përdorimin e qëndrueshëm të fondit pyjor publik,
- Të ndihmojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve pyjore,
- Të përmirësojë shërbimet publike dhe të ardhurat nga fondi pyjor për komunitetin lokal,
- Të parandalojë degradimin e pyjeve dhe përdorimin e paligjshëm të tyre.

IV. PËRMBAJTJA E PLANIT

Plani i Mbarështrimit të Pyjeve përfshin:

- Inventarizimin e fondit pyjor (sipërfaqja, llojet e drurëve, vjetërsia, dendësia, etj.),
- Hartën pyjore dhe ndarjen në zona funksionale,
- Masat e menaxhimit dhe mirëmbajtjes (p.sh. pastrimi, prerjet selektive, rigjenerimi, mbrojtja kundër zjarreve dhe erozionit),
- Angazhimin e komunitetit lokal në bashkëmenaxhim dhe edukim mjedisor,
- Masa për zhvillimin ekonomik lokal përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve,
- Parashikime për investime në infrastrukturën pyjore dhe trajnim të stafit përgjegjës.

V. REZULTATET E PRITSHME



Zbatimi i Planit të Mbarështrimit të Pyjeve pritet të sjellë:

- Përmirësimin e cilësisë së fondit pyjor dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra,
- Uljen e dëmeve nga zjarret dhe prerjet e paligjshme,
- Të ardhura për bashkinë dhe komunitetin përmes shfrytëzimit të kontrolluar të produkteve pyjore,
- Rritjen e ndërgjegjësimit për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

VI. KONKLUSIONE DHE KËRKESË

Duke marrë parasysh rëndësinë e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve për mjedisin, zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e komunitetit, kërkohet:

Miratimi nga Këshilli Bashkiak i Planit të Mbarështrimit të Pyjeve për Bashkinë Divjakë, si një dokument strategjik që do të orientojë menaxhimin dhe zhvillimin e këtij sektori për 10 vitet e ardhshme.